

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
GAIA SHPK**

---

**NENI 1**  
**EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë është “GAIA” SHPK (në vijim e referuar si “Shoqëria”).

**NENI 2**  
**SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Urani Pano, Ndërtesa nr. 5, Hyrja 8/1, Ap. 19, Tiranë.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për të transferuar selinë e Shoqërisë në një vend tjetër. Organi i administrimit të Shoqërisë ka të drejtë të hapë dhe të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**


- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I AKTIVITETIT**

- 4.1 Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë sipas ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa u kufizuar në:
- 4.1.1 Zhvillimin dhe ndërtimin e kompleksit rezidencial “GAIA” në Mullet, Tiranë, dhe shitjen e njërive ndërtimore përkatëse, përfshirë marrjen e lejeve të nevojshme dhe lidhjen e kontratave me pronarët e truallit ku do të zhvillohet kompleksi, aplikim për leje ndërtimi pranë organeve kompetente, etj.
- 4.1.2 Aktivitet në fushën e investimeve në ndërtim, projektim, ndërtim objektesh të ndryshme, zbatim punimesh, konsulencë në fushën e ndërtimit, ndërtime të ndryshme civile si ndërtesa shumëkatëshe banimi dhe shërbimesh, komplekse rezidenciale, vila, shtëpi, ndërtim rrugësh, urash dhe infrastrukturash të ndryshme;
- 4.1.3 Shitje, blerje dhe veprime të ndryshme me pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, qiradhënie pasurish të paluajtshme, etj.
- 4.1.4 Import dhe eksport produktesh dhe shërbimesh të ndryshme, etj.
- 4.2 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj, përfshirë zotërimin e pjesëmarrjeve në shoqëri e subjekte të tjera juridike, me qëllim realizimin sa më të mirë të objektit të saj të aktivitetit.

**NENI 5**  
**KAPITALI DHE FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Leke, i ndarë në 4 (katër) kuota, si më poshtë vijon:
- 5.1.1 Ortaku shoqëria “**Roen Company**” Shpk, NUIS K41914802Q, me seli në Tiranë, Rruga e Dibrës, Qendra e Biznesit “Observator”, kati XII, nënshkruan një kuotë të barabartë me 39.000 (tridhjetë e nëntëmijë) Lekë e barazvlefshme me 39% e kapitalit të Shoqërisë;
- 5.1.2 Ortakët **Z. Durim Kraja**, shtetas shqiptar i datëlindjes 14/11/1966, lindur në Shkodër dhe me banim në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit personal nr. 035913226, nr. personal G61114089I, dhe **Znj. Dida Kraja**, shtetase shqiptare e datëlindjes 03/07/1972, lindur dhe me banim në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit personal nr. 035663513, nr. personal H25703062V, nënshkruajnë dhe zotërojnë në bashkëpronësi një kuotë të barabartë me 32.000 (tridhjetë e dy mijë) Lekë e barazvlefshme me 32% të kapitalit të Shoqërisë;
- 5.1.3 Ortaku shoqëria “**Energy Consulting**” Shpk, NUIS K72209002T, me seli në adresën Rr. Besim Alla, pallati nr. 20, Ap. 23, kati 6, Yzberish, Kashar, Tiranë, nënshkruan dhe zotëronë një kuotë të barabartë me 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Lekë e barazvlefshme me 15% të kapitalit të Shoqërisë;
- 5.1.4 Ortaku shoqëria “**Archimed International**” Shpk, NUIS J71931003R, me seli në adresën Rruga Urani Pano, Ndërtesa nr. 5, Hyrja 8/1, Ap. 19, Tiranë, nënshkruan dhe zotëron një kuotë të barabartë me 14.000 (katërmëdhjetë mijë) Lekë e barazvlefshme me 14% të kapitalit të Shoqërisë.
- 5.2 Shoqëria do të financohet nga ortakët përpjesëtimisht me kuotat e kapitalit që ata zotërojnë në Shoqëri, si edhe në përputhje me marrëveshjen e ortakëve dhe aktet e tjera të dakortësuara mes palëve. Ortakët kanë të drejtë të barrësojnë, të lenë peng apo të përdorin si kolateral kuotën e tyre në Shoqëri, por në çdo rast pa përfshirë dhe pa krijuar detyrime për ortakët e tjerë dhe/ose Shoqërinë. Shoqëria në asnjë rast nuk do të garantojë apo veprojë si dorëzanës për financimin e ortakëve të saj, duke përdorur kolaterale, të drejtat dhe asetet e saj. Shoqëria nuk do të marrë financime nga bankat, institucionet financiare apo të tretët pa miratimin paraprak me shkrim së të gjithë ortakëve të saj.
- 5.3 Ortakët bien dakord se në rast se për ortakët që nuk do të paguajnë pjesën takuese të financimit në Shoqëri do të veprohet në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së ortakëve. Në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, ortaku mospërbushës në financim do të humbasë veçanërisht të drejtat e parashikuara në nenin 6 të këtij akti për të penguar, refuzuar apo kundërshtuar pranimin e të tretëve si ortakë në Shoqëri.
- 5.4 Ortakët bien dakord shprehimisht dhe pranojnë pa kundërshtime e rezerva se mospagimi nga ortaku i pjesës takuese të financimit në Shoqëri, sipas biznes-planit, situacioneve dhe grafikut të punimeve që do të miratohen nga ortakët, përbën shkelje të rëndë të kushteve të marrëveshjes së ortakëve dhe të këtij akti, si edhe përbën shkak




për pezullimin e të drejtave të votës në Asamblenë e Përgjithshme deri në anulimin nga Shoqëria të kuotës së ortakut mospërmbushës. Ortakët njohin dhe pranojnë se kuotat e Shoqërisë janë vlerësuar dhe shprehur në përqindje nga ortakët në të njëjtin raport që ortakët kanë në financimin që duhet të lëvrojnë në Shoqëri dhe çdo ndryshim në raportet e financimit efektivisht të lëvruar nga ortakët do të pasqyrohet edhe në kuotat e në përqindjen e kapitalit që do të zotërojnë ortakët në Shoqëri, duke u kryer të gjitha veprimet e nevojshme në kapitalin e Shoqërisë. Ortaku mospërmbushës angazhohet të veprojë në mirëbesim dhe të mos pengojë vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme që do të vendosë mbi ndryshimet në kapitalin e Shoqërisë në mënyrë që kuota e këtij ortakut të pasqyrojë përpjesëtimisht financimin që ky ortak ka lëvruar efektivisht në Shoqëri në raport me vlerën totale të financimit të dakortësuar mes Palëve.

- 5.5 Financimet e lëvruara nga ortakët e Shoqërisë do të paguhet përpara shpërndarjes së dividendit nga kjo e fundit. Financimi i lëvruar nga ortakut mospërmbushës sipas përcaktimeve të marrëveshjes së ortakëve dhe të këtij akti do të jetë i nënrenditur në raport me të gjithë financimet e lëvruara nga ortakët e tjerë e Shoqërisë dhe do të shlyhet vetëm pasi të jenë shlyer të gjithë financimet e këtyre të fundit.
- 5.6 Ortakut mospërmbushës në financimin e Shoqërisë, në përputhje me marrëveshjen e ortakëve, i pezullohet e drejta e votës në Asamblenë e Përgjithshme dhe Shoqëria gëzon të drejtën e anulimit të kuotës së këtij ortakut me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e zakonshme të parashikuar në nenin 9.7 të kësaj Marrëveshjeje. Ortaku mospërmbushës në financimin e Shoqërisë nuk mund të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që do të vendosë mbi anulimin e kuotës së tij dhe kuota e zotëruar prej tij nuk do të llogaritet në kuorumin vendimmarrës të Asamblesë së Përgjithshme. Likuidimi i kuotës së anuluar nga Shoqëria do të bëhet brenda afatit që do të përcaktohet në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme që do të thirret për këtë qëllim.

## NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 6.1 Transferimi i kuotave mes ortakëve të Shoqërisë do t'iu njoftohet paraprakisht me shkrim ortakëve të tjerë, bashkë me projekt marrëveshjen e shitjes apo kalimit të kuotës, çmimin apo kundërshpërblimin për transferimin e kuotës dhe kushtet e pagesës. Transferimi i kuotës mes ortakëve të Shoqërisë mund të kryhet vetëm pasi ka kaluar afati 30 ditor nga njoftimi i transferimit sipas nenit 6.1 të këtij akti.
- 6.2 Asnjë prej ortakëve nuk mund t'iu transferojë të tretëve jo ortakë kuotën që zotëron në Shoqëri, pa miratimin paraprak me shkrim të gjithë ortakëve të tjerë. Ortaku që dëshiron t'iu transferojë të tretëve jo ortakë, në cilindo formë e titull, përfshirë por pa u kufizuar, në formën e shitjes, dhurimit, kalimit kundrejt shpërblimit, shkëmbimit, të gjithë ose pjesë të kuotës së tij në Shoqëri, ose çdo mënyrë tjetër apo të drejta që lidhen me kuotën është i detyruar të njoftojë me shkrim administratorin dhe të gjithë ortakët e Shoqërisë. Ky njoftim duhet të përmbajë projekt kontratën e transferimit apo kalimit të kuotës, kuotën që kërkohet të transferohet dhe formën e kalimit të saj, të dhënat personale identifikuese të blerësit apo personit të cilit i kalon kuota si kopjen e dokumentit të identifikimit të blerësit person fizik ose të dhënat identifikuese të subjektit person juridik, të shpërblimit apo çmimit të ofruar për kalimin e kuotës, mënyrat, afatet dhe kushtet e pagesës dhe garancitë e mundshme. Ortakët e tjerë kanë



të drejtë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes sipas kushteve të transferimit të njoftuara nga ortaku transferues, brenda afatit 30 ditor nga njoftimi i ortakut transferues sipas nenit 6.2 të këtij akti.

- 6.3 Kuotat e Shoqërisë mund t'iu transferohen të tretëve vetëm nëse ortakët nuk kanë ushtruar të drejtën e parablerjes, në përputhje me nenin 6.2 të këtij akti, dhe kanë miratuar shprehimisht me shkrim transferimin e kuotës tek të tretët. Në rast se ortakët nuk janë shprehur brenda afatit 30 ditor nga njoftimi i transferimit të kuotës, sipas neneve 6.1 dhe 6.2 të këtij akti, konsiderohet se është refuzuar miratimi i transferimit të kuotës tek të tretët dhe ortaku transferues nuk mund të transferojë kuotën në Shoqëri tek të tretët jo ortakë të Shoqërisë.
- 6.4 Në rast të miratimit të transferimit të kuotës nga të gjithë ortakët e Shoqërisë tek të tretët jo ortakë, ky transferim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse të tretët jo ortakë pranojnë kushtet e marrëveshjes së ortakëve. Çdo transferim i tentuar kuotash i Shoqërisë në kundërshtim me kushtet e këtij akti dhe të marrëveshjes së ortakëve do të jetë i pavlefshëm dhe do të ngarkojë me përgjegjësi ortakun që ka vepruar në kundërshtim me sa më sipër.
- 6.5 Përjashtimisht nga sa parashikohet më sipër, ortakut të Shoqërisë mospërbushës në financim, në kuptim të sa më sipër dhe të marrëveshjes së lidhur mes ortakëve, i shuhen të drejtat e parashikuara në nenin 6 të këtij akti vetëm në lidhje me ushtrimin e të drejtës së parablerjes dhe refuzimin e të tretëve si ortakë në Shoqëri. Në çdo rast, transferimi i kuotës së ortakut mospërbushës do t'i nënshtrohet rregulimeve dhe përcaktimeve të nenit 6 të këtij akti dhe të parashikimeve të marrëveshjes së ortakëve.

## NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kapitali mund të rritet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e cilësuar, e parashikuar në këtë Statut.
- 7.2 Kontributet në natyrë do të vlerësohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet ortakëve. Në rast se ortakët nuk bien dakord mbi vlerën e kontributit në natyrë, secili prej tyre mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për emërimin e një eksperti.
- 7.3 Nëse ortakët heqin dorë nga e drejta për të nënshkruar zmadhimin përkatës të kapitalit apo nuk e ushtrojnë këtë të drejtë brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi i kapitalit mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë ose nga palët e treta të interesuara, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes mes ortakëve dhe të këtij akti.

## NENI 8 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë Statut. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili ortak në përpjesëtim të drejtë me kuotën e zotëruar në Shoqëri, përveç kur është rënë dakord ndryshe mes ortakëve.

## NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas marrëveshje të ortakëve dhe këtij akti. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri, përveç kur në këtë akt dhe në marrëveshjen e ortakëve është parashikuar ndryshe. Çdo ortak mund të përfaqësohet në mbledhje nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i autorizuar me shkrim.
- 9.2 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*) audio dhe/ose video, në përputhje me ligjin. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori ose nga secili prej ortakëve të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, letërporosi, apo e-mail të dërguar në adresën e komunikuar nga ortakët e Shoqërisë, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 9.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i cili zgjidhet nga personat e pranishëm. Kryetari cakton një sekretar për çdo mbledhje.
- 9.5 Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, procesverbalet dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përfshijnë, në mënyrë të përmbledhur, edhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.6 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, si edhe sa herë që thirret nga administratori apo ortakët e Shoqërisë.
- 9.7 Asambleja e Përgjithshme, përveç rasteve të parashikuara në nenin 9.8 të këtij akti, merr vendime me shumicën e votave të ortakëve me të drejtë vote që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të Shoqërisë.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme vendos me votën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 76% të kapitalit të Shoqërisë për çështjet e mëposhtme:



- a) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e Statutit të Shoqërisë;
- c) bashkimin, ndarjen, riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë;
- d) ndryshimet në objektin e aktivitetit të Shoqërisë;
- e) shpërndarjen e dividendit;
- f) zmadhimin apo zvogëlimin e shpenzimeve të Shoqërisë në masën mbi 5% nga ato të parashikuara në biznes-planin e miratuar të Shoqërisë.

## NENI 10 ADMINISTRIMI

- 10.1 Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një administrator i vetëm, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori do të zgjidhet, rizgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila përcakton edhe shpërblimin e tij.
- 10.2 Administratori gëzon tagra të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë çdo veprim që e vlerëson të nevojshëm për realizimin e objektit të saj, përveç akteve që janë në kompetencën e Asamblesë së Përgjithshme ose të organeve të tjera të Shoqërisë.
- 10.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e veprimeve të caktuara dhe përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt të tretëve për një periudhë kohore të caktuar. Administratorët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, administratori i përfshirë do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit për mbledhjet, diskutimet dhe/ose çështjet e tjera të brendshme të Shoqërisë.
- 10.4 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë Z. Durim Kraja, shtetas shqiptar i datëlindjes 14/11/1966, lindur në Shkodër dhe me banim në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit personal nr. 035913226, nr. personal G61114089I, i zgjedhur në detyrë për një 1 (një) vit nga data e nënshkrimit të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

## NENI 11 VITI FINANCIAR, KONTROLLI FINANCIAR DHE DIVIDENDI

- 11.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare vjetore, raportet e administratorit apo të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Organi administrues është i detyruar t'i paraqesë për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore, në përputhje me ligjin.
- 11.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.3 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga auditues ligjorë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më

shumë auditues ligjorë në të gjitha ato raste kur emërimi i tyre është i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

- 11.4 Në përputhje me dispozitat e ligjit, Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë. Fitimet do t'iu shpërndahen ortakëve përpjesëtimisht me kuotën që ata zotërojnë në Shoqëri, përveç kur në këtë akt dhe në marrëveshjen e ortakëve është parashikuar ndryshe. Në përputhje me rezultatet financiare të Shoqërisë dhe marrëveshjen e ortakëve, Shoqëria do të shpërndajë të gjithë dividendin e realizuar në periudhën përkatëse financiare. Dividendi do t'iu paguhet ortakëve jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga miratimi i bilancit të viti ushtrimor dhe i destinimit të fitimeve nga Asambleja e Përgjithshme.


## NENI 12 DISPOZITA TË NDRYSHME


- 12.1 Në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi, si edhe parashikimet e marrëveshjes së ortakëve të Shoqërisë.
- 12.2 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat ligjore, marrëveshjen e ortakëve dhe këtë akt. Dispozitat e ligjit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky statut dhe nga marrëveshja e ortakëve.
- 12.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë, ortakëve dhe personave që tërheqin të drejta, organit administrues dhe Shoqërisë do të jenë objekt konsultimi miqësor ndërmjet palëve, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga lindja e mosmarrëveshjes ose nga data në të cilën mosmarrëveshja i është komunikuar me shkrim të paktën njëerës prej palëve. Në rast se mosmarrëveshja nuk do të mund të zgjidhet miqësisht, ajo do të gjykohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 12.4 Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet nga palët në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Tiranë, më 05/10/2020.


### ORTAKËT

**Shoqëria Roen Company Shpk**  
E përfaqësuar nga administratori **Z. Rreoland Jegeni**


  
\_\_\_\_\_  
**Z. Durim Kraja**



**Znj. Dida Kraja**

  
\_\_\_\_\_

**Shoqëria Energy Consulting Shpk**  
E përfaqësuar nga administratori **Z. Elton Nino**

  
\_\_\_\_\_  
**Energy Consulting**  
Sh.p.k.  
Tiranë - Albania



Shoqëria Archimed International Shpk  
E përfaqësuar nga administratori Z. Ardian Asllani

*[Handwritten signature]*

